

## UNIVERSITETI POLIS, NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

### KIMIST ANALITIK

#### PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

Universiteti POLIS, nëpërmjet këtij njoftimi, kërkon të punësojë një **Kimist Analitik**, i cili do të punojë në laboratorin e Mjedisit për kryerjen e analizave të tokës, ujit dhe bimëve si dhe të ndihmojë në kryerjen e praktikave laboratorike me studentët.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Analiza kimike e fizike të mostrave të tokës, ujit e bimëve për qëllim eksperimentale dhe për punime shkencore të diplomave të studentëve
- Analiza kimike e fizike të mostrave të tokës, ujit e bimëve për projekte që zhvillohen
- Analiza kimike e fizike të mostrave të tokës, ujit e bimëve nga porositë për të tretët.
- Të krijojë regjistrin e pranimit të mostrave dhe të hedhjes së të dhënave të rezultateve të analizave të kryera
- Të plotësojë metodikat e analizave laboratorike sipas standarteve
- Të bashkëpunojë me stafin në procesin e praktikave me studentët
- Të krijojë bazën e të dhënave laboratorike
- Të zbatojë rregulloren e miratuar të laboratorit
- Përgjigjet për mirëmbajtjen e laboratorit, pajisjeve, aparaturave dhe kimikateve
- Punon për akreditimin e laboratorit nga institucionet përgjegjëse.

#### Kualifikimet / Kërkesat:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Kimi Industriale dhe Mjedisore / Kimi e Përgjithëshme që plotëson kërkesat e këtij pozicioni
- Të ketë experiençë pune jo më pak se 5 vjet në kryerjen e analizave kimike e fizike të tokës, analizat kimike të ujit dhe analizat e metaleve të rënda.
- Të njohë dhe të përdorë pajisjet, aparaturat dhe reagentët për të kryer analizat e sipërpërmendura.
- Të njohë metodat analitike, standartet, të kryejë analizat, të jetë i aftë të bëjë interpretimin e analizave të përfituara dhe të formulojë rekomandimet për qëllimin për të cilën analizat kryhen.

#### DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Cv (Curriculum Vitae)  
Diplomë  
Tituj / Grada Shkencore  
Liçenca Profesionale  
Dy letra reference

**APLIKIMET MUND TË DËRGOHEN NË ADRESËN E MËPOSHTME**

E-mail: [rektorati@universitetipolis.edu.al](mailto:rektorati@universitetipolis.edu.al)

Aplikimi është i hapur deri më datën 25.04.2017, ora 16:30.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë.